

UNIVERSITETI “FEHMI AGANI” GJAKOVË

FAKULTETI I MJEKSISË

DREJTIMI – INFERMIERI



PUNIM DIPLOME

**SHQETËSIMET GASTROINTENSTINALE
TEK PACIENTET ONKOLOGJIK, KUJDESI
DHE TRAJTIMI**

Punoi:

Arlinda Gjuveri

Mentori:

Prof.Ass.Dr. Dardan Koçinaj

Gjakovë, Nëntor 2017

Punimi është bërë në Universitetin e Gjakovës, Fakulteti i Mjekësisë, Drejtimi
Infermieri .

Mentori i kësaj teme është Prof. Ass. Dr. Dardan Koçinaj.

Punimi përmban:

47 Faqe

13 Figura

6 Tabela

Shkurtesat:

GI- Gastrointestinale

OBSH- Organizata boterore e Shëndetsisë

EKG- Elektro kardio gram

SHBA- Shtetet e bashkuara të Amerikes

Ca- Kancer

X-ray- Rengen

GVHD- Graft-versus-host-it

Deklaratë studentore:

Unë, si studente e Universitetit të Gjakovës - Fakultetit të Mjekësisë e zgjodha këtë temë për punimit të diplomës dhe nuk kam lejuar që punimi im të devijojë nga origjinaliteti.

Me këtë dëshirojë të theksojë që i gjithë materiali i përfshirë në punim është i marr nga referencat e listuara si me poshtë.

“Unë studentja Arlinda Gjuveri deklaroi se punimi i diplomës më titull Shqetësimet Gastrointestinale tek Pacientet Onkologjik, Kujdesi dhe Trajtimi është punim i imi dhe nuk është i vjedhur”

Falënderimet:

Për rezultatet e arritura deri me tani:

Falënderimi i takon Zotit dhe familjes time për mbështetjen që më dhanë në çdo aspekt.

Falënderoj mentorin tim Prof.Ass.Dr Dardan Koçinaj, i cili gjithmonë gjeti kohë

për të më ndihmar në realizimin e këtij punimi, andaj e falënderoj për durimin,

korrektësinë dhe këshillat e të tij gjatë gjithë kësaj periudhe.

PËRMBAJTJE:

ABSTRAKTI.....	7
2.HYRJE.....	8
2.1.Sistemi i organeve tretëse	8
2.2. Onkologjia	12
2.3. Kanceri (Ca).....	12
2.4. Përhapja e kancerit.....	14
2.5. Modalitetet e trajtimit	15
2.6.ETIOLOGJIA	17
2.7.Konstipacioni (Kapslleku)	18
2.8. Opstipacioni	19
2.9.Zvogëlimi i lumenit të zorres.....	20
2.10.Diarrea	21
2.11.Enteriti rrezatues	22
2.12. Vjellja.....	24
2.13. Mundim në vjellje (Nauze)	24
2.14.Kujdesi ndaj pacienteve onkologjik.....	25
2.15. Trajtimi	27
2.16. Trajtimi i konstipacionit.....	27
2.17.Trajtimi i opstipacionit.....	28
2.18.Trajtimi i zvoglimit të lumenit të zorrëve	29
2.19.Trajtimi i diares.....	30
2.20.Trajtimi i enteritit rrezatues	30
2.21.Trajtimi i të vjellave dhe nauzes	32
2.22.Ushqyeshmeria (Nutricioni)	32
2.23.Edukimi shëndetsor.....	33
2.24.Edukimi i pacientit dhe praktikat infermiere.....	34
2.25.Edukimi i pacientit i përfshirë në procesin infermior	34
3.QËLLIMI I PUNIMIT	36
4.METODOLOGJIA (MATERIALET DHE METODAT)	37
5.REZULTATET	38
6.DISKUTIME	41
7. PËRFUNDIMI.....	42

8.REKOMANDIMET INFERMIERORE	43
9. A. REZYME	44
9.B. SUMMARY	45
10. REFERENCAT:.....	46

ABSTRAKTI

Ky punim është realizuar me qëllim të shtjellimit të njohurive të lidhura më shqetësimet gastrointestinale tek pacientet onkologjik si dhe me kujdesin dhe trajtimin e tyre.

Lexuesit mund të informohen më konkretisht më gjëndjen e pacienteve me semundje onkologjike si dhe kujdesin e tyre.

Punimi është bërë në Universitetin e Gjakovës, Fakulteti i Mjekësië, Programi Infermieri, gjithmonë në bashkëpunim me mentorin e temës Prof.Ass.Dr Dardan Koçinaj.

Përmes këtij punimi kemi paraqitur edhe trajtimin e kujdesit paliativ tek personat me semundje onkologjike.

2.HYRJE

Shëndeti digjestiv është tepër i rëndësishëm për organizmin, dhe një tregues i mirë për funksionimin e sistemeve të tjera në trup. Funkzioni i tij është tretja e ushqimit që ne konsumojmë si lëndët ushqyese dhe energjike, dhe më pas ti shpërndajë ato në mënyrë të barabartë nëpër trup. Sistemi i tretjes dhe sistemi imunitar janë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin, për faktin se 70% e sistemit imunitar qëndron në traktin digjestiv. Sistemi digjestiv është i ndertuar nga një sistem i organeve të tretjes. Varësisht se nga cila sëmundje atakohet tek ky sistem mund të paraqiten nderlikime me natyra të ndryshme të manifestimeve.

2.1.Sistemi i organeve tretëse

Ushqimin që e marrim, në pikëpamje fizike dhe kimike është i ndryshëm, që të mund të shfrytëzohet, duhet ti nënshtrohet ndryshimeve fiziko-kimike, këto funksione të nderlikuara kryhen në sistemin e organeve tretëse.¹

Sistemi i organeve tretëse është i përbër nga këto pjesë :

- Zgavra e gojës (cavum oris),
- Fyti (pharynx),
- Kapërçelli (oesophagus),
- Lukthi (gaster-ventriculus),
- Zorra e hollë (intestinum tenue),
- Zorra e trashë (intestinum crassum)




Fig.1. Sistemi digjestiv²

¹ Totozani.D, Qamirani.S Anatomia normale e njeriut, Pjesa e pare Tiranë, 2001: 139

²<https://www.google.com/search?q=sistemi+gastrointestinal&source=lnms&tbm=isch&sa=X&ved=0ahUKewif>

2.1.1. Zgavra e gojës

Zgavra e gojës përpara përkufizohet më buzët (labia oris) kurse prapa me hyrjen në laring (isthmus faucium). Zgavra e gojës ndahet në dy pjesë: të përparme- hyrja e gojës (vestibulum oris) dhe e prapme-zgavra e vërtetë (cavum oris proprium).

2.1.2. Gjuha

Gjuha është e përbër nga shumë muskuj që marrin pjesë në përpunimin mekanik të ushqimit, qëllitjes së ushqimit dhe luan rol të rëndësishëm në të folurit.

Dhëmbët (dentes) janë organe eshtërore të ngulura në nofulla. Ndahen në dhëmbë qumeshtorë (dentes decidui) dhe të përhershëm (d. permanentes).

Gjëndrat pështimore (glandulae oris). Keto janë gjëndra të cilat ekskretin e tyre, pështymën (saliva) e derdhin në gojë. Ekzistojnë tri pale gjëndra nëngjuhësore pështimore: - nëngjuhësore (gl.sublingualis)
- nënofullore (gl.submandibularis) dhe
- pranëveshore (gl. parotis) ³

2.1.3. Kapërçelli-ezofagu

Kapërçelli-ezofagu është gyp muskolor, që lidh fytin me lukthin. Gjatësia është 23-25cm, gjërësia 2-3cm. Fillimin e ka në lartësinë e vërtebres së VI qafore, pastaj lëshohet teposhtë dhe duke kaluar në vrimën diaframatike, hyn në zgavrën barkore dhe vazhdon në lukth.

2.1.4. Lukthi (gaster-ventriculus)

Lukthi është i pozicionuar në anën e majtë, menjëherë nën diafragmë, dhe është pjesërisht i mbuluar nga brinjët. Stomaku ka formë fasuleje, me një lakesë të vogël dhe një lakesë të madhe. Ndahet në tre pjesë: fundi, trupi dhe pjesa pilorike. Stomaku punon si rezervuar për ushqimin. Pjesa e jashtme e stomakut përbëhet nga tri shtresa, këto tri shtresa muskujsh kanë funksionin e përzjerjes së ushqimit me lëngun gastrik dhe shpërndarjen e tij në duodenum. Veshja mukoze thith ujin dhe glukozën për

³ Totozani.D, Qamirani.S Anatomia normale e njeriut, Pjesa e pare , Tiranë, 2001: 139-150

në gjak. Gjendrat gastrike tajojnë (sekretojnë) rreth 1-2 litra lëng gastrik në ditë. Lëngu gastrik përmban enzima si lipaza dhe pepsinogjeni, të cilat prodhohen nga qelizat peptike. Lipaza kryen keto funksione; pepsinogjeni shndërrohet në pepsinë në prani të acidit klorhidrik. Pepsina fillon shendrrimin kimik të proteinave në substanca më të thjeshta si peptonët. Acidi klorhidrik ka rolin e eliminimit të baktereve. Në mënyrë që të parandalojë vet-tretjen nga acidi klorhidrik, qelizat mukoze tajojnë (sekretojnë) mucinën, që mbron sipërfaqen e stomakut.

Stomaku është nën kontroll hormonal dhe nervor. Kur ushqimi mbërrin në stomak, qelizat gastrike fillojnë taitjen e gastrinës. Gastrina vepron mbi mbi qelizat e stomakut për të rritur taitjen e lëngut gastrik. Pas lënies së kohës së duhur për tretje, fillon tkurrja e muskujve të stomakut duke krijuar lëvizjet peristaltike. Këto lëvizje e shtyjnë ushqimin drejt pjesës pilorike të stomakut. Sfinkteri pilorik hapet dhe ushqimi shtyhet drejt zorrën së hollë (duodenumit).⁴

2.1.5. Zorra e hollë

Zorrët mund të ndahen në zorrën e hollë dhe zorrën e trashë, zorra e hollë është një tub i gjatë muskolor. Zorra e hollë përfshin duodenumin, jejunumin dhe ileumin.

2.1.6. Zorra e trashë

Zorra e trashë është e veshur nga një membranë (cipë) seroze – peritoneumi, në të cilën kalojnë enë gjaku, enë limfatike dhe nerva. Zorra e trashë përbëhet nga , koloni, rektumi, kanali anal dhe apendiksi-krimb.

2.1.7. Mëlçia

Mëlçia është një organ metabolik kompleks, dhe është po ashtu gjendra me taitje të jashtme më e madhe e trupit. Mëlçia gjendet në zgavrën abdominale, nën diafragmë në anën e djathtë. Është e rrethuar nga një kapsulë indi fibroz që e ndan në dy lobe kryesore:; lobi i majtë dhe i djathtë, që më tej janë të ndarë në lobuse më të vogla. Arteria hepatike shpie në mëlçi gjak arterioz, ndërsa vena portë (portale) shpie në mëlçi gjakun venoz të organeve abdominale. Pasi gjaku kalon në kapilarët e mëlçisë –

⁴ Totozani.D, Qamirani.S Anatomia normale e njeriut, Pjesa e pare, Tiranë, 2001: 151-156

sinusoidët – ai kalon në venën heptike (e mëlçisë) dhe më në fund në venën zgavrore të poshtme. Nga mëlçia lindin dy dukte hepaticke, që bashkohen për të formuar duktin e përbashkët hepatic. Dukti i përbashkët hepatic vazhdon në duktin e përbashkët të vrerit, që më pas derdhet në duodenum pasi takohet me duktin pankreatik.

2.1.8.Fshikëza e tëmthit

Fshikëza e tëmthit është një pjesë me funksionin e rezervimit të vrerit. Fshikëza e tëmthit është në fakt organi ku rezervohet vreri pasi është sekretuar nga hepatocitët. Fillimisht kalon në duktet e vrerit, mëpastaj në dukte me diametër gjithnjë e më të madh deri sa kalonë në duktin hepatic të përbashkët i cili më tej duke u bashkaur me duktin cistik formon duktin vreror të përbashkët. Dukti cistik është dukti (tubthi) në të cilin kalon vreri për t'u futur dhe për të dalë nga fshikëza e tëmthit. Pra funksioni i fshikëzës së tëmthit është ai i rezervimit dhe i përqëndrimit të vrerit, meqë nga ky largohet vazhdimisht ujë.⁵

2.1.9. Pankreasi

Pankreasi është një gjendër e gjerë që shtrihet përmes zgavrës abdominale të pasme. Pankreasi ka një funksion jashtëtairës (ekzokrin) apo tretës dhe një funksion brendatitës apo hormonal. Pankreasi përbëhet nga koka, trupi dhe bishti. Koka e pankreasit është e rrethuar nga duodenumi.

Pankreasi përshkohet nga dukti pankreatik, i cili bashkohet me duktin e vrerit dhe më pas del në duodenum ku derdh lëngun pankreatik, nëpërmjet ampulës së Vater-it. Ampula e Vater-it përfundon me sfinkterin e Oddi-t.⁶

⁵ <https://rinstinkt.wordpress.com/2014/06/13/vreri-sekretimi-i-vrerit/>

⁶ Totozani.D, Qamirani.S Anatomia normale e njeriut, Pjesa e pare, Tiranë, 2001: 160-171

2.2. Onkologjia

Onkologjia mjekësore mbulon jo vetëm trajtimin e pacientëve me kancer, por edhe mbrojtjen nga kanceri, zbulimin e kancerit dhe aplikimet e hershme diagnostike. Me fjalë të tjera, çdo fazë e kancerit është një çështje e onkologjisë mjekësore. Për më tepër, në diagnozën dhe trajtimin e kancerit ka një bashkëpunim në mes të fushave të ndryshme të tilla si kirurgjisë dhe radiologjisë. Qasja ndaj pacientëve është planifikuar si një multidisiplinë në përputhje me të dhënat shkencore. Trajtimi kryhet me anë të medikamenteve në rrugë intravenoze ose me gojë, megjithatë kjo praktikë ndryshon në varësi të llojit të kancerit. Ndryshimet e planifikimit të trajtimit dallojnë në bazë të llojit qelizave të kancerit, organin ku së pari shfaqet dhe zonat në të cilat ajo është përhapur. Trajtimi kryhet si një trajtim ndihmës për të zvogëluar rrezikun e përsëritjes së çrregullimeve, si një trajtim neo-adjutant për të vënë pjesën më të madhe në dispozicion për funksionimin ose për të mbrojtur organet, ose si një trajtim paliativ që të zgjasë jetën gjatë çrregullimeve në fazat e mëvonshme dhe për të rritur cilësinë e jetës.⁷

2.3. Kanceri (Ca)

Është sëmundje në të cilat qelizat anormale ndahen pa kontroll dhe mund të pushtojnë indet e afërta, njihen ndryshe si qeliza të kancerit (Ca). Qeliza të kancerit mund të përhapen në pjesë të tjera të trupit përmes gjakut dhe sistemit limfatik.

Ka disa lloje kryesore të kancerit.


Karcinoma është një kancer që fillon në lëkurë ose në indet që vijojnë ose mbulojnë organet e brendshme. **Sarkoma** është një kancer që fillon në kocka, kërc, yndyrë, muskul, enët e gjakut ose inde të tjera lidhëse ose mbështetëse. **Leukemia** është një kancer që fillon në indet formuese të gjakut, të tilla si palca e eshtrave dhe shkakton një numër të madh të qelizave anormale të gjakut që të prodhohen dhe hyjnë në gjak.⁸

Limfoma dhe mieloma e shumëfishtë janë kancere që fillojnë në qelizat e sistemit imunitar.

⁷ Hanahan D. Rethinking war on cancer. Lancet 2014, 383:558-563 Malignant diseases, Kumar.P, Clark.M, Ninth edition Kumar & Clark's Clinical Medicine, 2017

⁸ Hoijmakers JH. DNA damage, aging and cancer. N Engl J Med 2009; 361:1475-1485
Kumar.P, Clark.M, Ninth edition Kumar & Clark's Clinical Medicine, 2017

Kanceret e sistemit nervor qendror (SNQ) janë kancere që fillojnë në indet e trurit dhe palcës kurrizore.



Kanceri është sëmundje që mund të shërohet nëse diagnostifikohet në kohë. Organizmi jonë është i përbërë prej trilionë qelizave, të cilat janë njësitë themelore strukturore dhe funksionale të të gjithë organizmat e gjalla, që trupi i njeriut të mbetet i shëndoshë, çdo ditë shumohen qeliza të reja dhe të shëndosha, ndërsa të vjetrat dhe ato jofunksionale vdes.

Fig.2. (Qeliza kancerore)⁹

Por, ndonjëherë ky procesi i ndërlikuar nuk zhvillohet sipas ligjeve të natyrës. Në një moment qelizat e vjetra dhe jofunksionuese, vazhdojnë të rriten dhe të shumohen në mënyrë të pakontrolluar.

Te qelizat normale nëse shfaqet ky problem, qelizat vdesin, ndërsa te qelizat anormale edhe krahas asaj që janë jofunksionale dhe të dëmtuara ato vazhdojnë të rriten. Qelizat e reja anormale, formojnë masë kancerogjene e cila quhet tumor.

Disa njerëz mund ta trashëgojnë kancerin, por në shumicën e rasteve, dëmtimi i ADN-së në qeliza dhe procesi i krijimit të kancerit, vijnë si pasojë e faktorëve të jashtëm si për shembull ekspozimi në diell.

Faktorët e rrezikut: faktorët kryesor të rrezikut janë: gjenet që bëjnë mutacion, hormonet, viruse dhe baktere të caktuara, karakteristikat ekologjike dhe biologjike ose mënyra negative e të jetuarit disa nga faktorët e shfaqjes së kancerit (tabela.1). Rreziku nga krijimi i kancerit mund të zvogëlohet nëse ndryshohen disa shprehje në stilin e jetesës siç është ndalja e pirjes së duhanit, evitimi i stresi, sporti, të jetuarit në mënyrë të shëndetshme dhe ushqimi i shëndetshëm¹⁰


⁹<https://www.google.com/search?q=qeliza+kancerogjene&source=lnms&tbn=isch&sa=X&ved=0ahUKEwi>

¹⁰ Hoijmakers JH. DNA damage, aging and cancer. N Engl J Med 2009; 361:1475-1485
Kumar.P, Clark.M, Ninth edition Kumar & Clark s Clinical Medicine, 2017

Tabela 1 Disa nga faktorët mjedisor që lidhen më shkaqet e kancerit .

Faktorët ngjitës	Neoplazmat
Duhanpirja	Goja, faring, ezofagu, laringu, buzët
Alkooli	Goja, faring, laringu, ezofagu, kolorektal
Esterogjenet	Endometriumi, vagina, qafa e mitres
Androgjene	Prostata
Dieta	
Dietë me yndyrë të lartë	Kolorektale
Fkatorët rrethues	
Ajri i ndotur	Kanceri në mushkri
Rrezet ultravjollcë	Likurë, buzë
Rrezatimet	Leukemia, kanceri i tiroides
Faktorët biologjik	
Hepatiti-B	Karcinoma e melçisë
Hepatiti-C	Karcinoma e melçisë
Helicobacter pylori	Stomak

2.4. Përhapja e kancerit



Qelizat e kancerit mund të përhapen në pjesët tjera të trupit përmes kokës dhe sistemit limfatik. Këtu fillojnë të krijohen tumore të reja, të cilat gjatë kohës e zëvendësojnë indin e shëndoshë. Procesi i përhapjes së qelizave kancerogjene quhet metastazë. Pa dallim ku është përhapur kanceri, ai gjithmonë emërohet sipas vendit ku

Fig.3.Përhapja e qelizave kancerore¹¹. është paraqitur për herë të parë. Për shembull, kanceri që është paraqitur në gji, dhe ka metastazuar në mëlçi quhet kancer metastatik i gjirit, dhe jo kancer i mëlçisë. Kanceret në pjesë të ndryshme të trupit, kanë karakteristika të ndryshme. Për shembull, kanceri i prostatës dhe kanceri i zorrës së trashë janë sëmundje të ndryshme. Për këtë arsye, për çdo kancer zbatohet terapi e ndryshme.¹²

¹¹<https://www.google.com/search?q=qeliza+kancerogjene&source=lnms&tbn=isch&sa=X&ved=0ahUKEwi#imgsrc=uSPF5P4qhDMH3M:>

¹² Hoijmakers JH. DNA damage, aging and cancer. N Engl J Med 2009; 361:1475-1485
Kumar.P, Clark.M, Ninth edition Kumar & Clark s Clinical Medicine, 2017

2.5. Modalitetet e trajtimit

Kimioterapia (Terapia mjekësore): Kimioterapia synon të shkatërrojë qelizat kanceroze që rriten në mënyrë të pakontrolluar për shkak të ndryshimeve në strukturat e tyre. Në shumicën e rasteve, qëllimi është për të vrarë qelizat kanceroze duke administruar medikamente në disa anë të mekanizmave të ndryshëm. Zhvillimet më të fundit në këtë fushë janë të monitoruara me trajtime efektive që aplikohen në qendrat onkologjike.



Fig.4.Kimioterapia¹³

Terapia hormonale: Medikamentet hormonale përdoren në trajtimin e tumorëve që janë të ndjeshme ndaj hormoneve të tillë si kanceri i prostatës dhe gjirit. Medikamentet në përgjithësi administrohen me gojë. Një tjetër metodë e aplikimit është edhe injeksioni.




Fig.5.Terapia hormonale¹⁴

Imunoterapia (Trajtimi i sistemit imunitar): Substancat e natyrshme që prodhon sistemi imunitar përdoren për të identifikuar dhe vrarë qelizat kanceroze duke e njoftuar sistemin imunitar të trupit.



Fig.6.Imunoterapia

Një nga zhvillimet më të rëndësishme të dekadës së fundit në trajtimin e kancerit ka qenë zhvillimi i terapive efektive biologjike me sa më pak efekte anësore të cilat identifikojnë substancat të cilat janë të pranishme në qelizat kanceroze e jo në qelizat normale.¹⁵ **Fig.7.Terapia biologjike me orientim nga objektivi**



¹³<https://www.google.com/search?biw=1517&bih=735&tbm=isch&sa=1&ei=13YEWjrjFMvRgAaL1qvICw&q=chemotherapy+drawing&oq>

¹⁴<https://www.google.com/search?biw=1517&bih=735&tbm=isch&sa=1&ei=KHgEWquhPM2tgAbk6ZGADg&q=hormonal+therapy&oq>

¹⁵ Donker M, van Teinoven G, Starver ME et al. Radiotherapy or surgery of the axilla after a positive sentinel node in breast cancer (EROTC 1098-22023 AMROS): a randomized, multicenter, open-label, phase 3 non-inferiority trial. Lancet Oncol 2014; 15:1303-1310 Kumar.P, Clark.M, Ninth edition Kumar & Clark's Clinical Medicine, Johnson.J.M, Eva.E.G, Booth.S, Palliative medicine and symptom control, 2017: 31-42

Kirurgjia kurative aplikohet nëse çrregullimi është i kufizuar në një organ ose në nyjet limfatike, ku për herë të parë është paraqitur. Te këta pacientë nuk do të duhej të jenë prezent metastazat e largëta dhe nuk duhet të ketë mbetje nga tumori në vendin e reseksionit kirurgjik. Tumori mund të hiqet tërësisht, me çka kufijtë e tij do të caktohen mirë. Megjithatë, ka raste kur tumori nuk mund të hiqet tërësisht. Në rastet e tilla aplikohet operacioni për zvogëlimin e masës së tumorit, me qëllim që të zvogëlohet presioni mbi indin në rrethinë dhe të mundësohet efekt më i mirë nga terapia e zbatuar në mënyrë plotësuese.¹⁶

Këto fusha janë grupuar në katër grupe kryesore:

Kirurgjia profilaktike: Mënjanimi kirurgjik i indeve, të cilët janë nën rrezik të bëhen malinje. Polipet e zorrëve, lëndimet dhe precancerous e lëkurës dhe impiante në gji, të cilat janë nën rrezik të bëhen kancerogjene, mund të mjekohen përmes kirurgjisë profilaktike.

Biopsia: Metodë e definuar si observim dhe evolucion patologjik i ekzemplarit të marrë gjatë intervenimit kirurgjik. Me biopsi mund të vendoset diagnozë e saktë histopatologjike.

Përcaktimi i stadiumit: Metodë e njohur si marrja e ekzemplarit nga pjesë të caktuara, me qëllim që të vërtetohet deri në cilën shkallë është përhapur çrregullimi.




Radioterapia (terapia me rreze jonizuese): Radioterapia është definuar si mjekimi me rrezatim i indit kancerogjen ose i disa tumoreve jo malinje. Rrezet e përdorura në radioterapi kanë për qëllim të pengojnë rritjen e qelizave kancerogjene ose t'i shkatërrojë të njëjtat.

Fig.8.Radioterapia

Radioterapia shpesh aplikohet në trajtimin e kancerit si e tillë, pas diagnostifikimit të kancerit, 60-80% të pacientëve me kancer kanë nevojë për radioterapi, veçanërisht në kancerin e gjirit, kancerin e zorrëve dhe kancerin e veshkave.

¹⁶ Donker M, van Teinoven G, Starver ME et al. Radiotherapy or surgery of the axilla after a positive sentinel node in breast cancer (EROTC 1098-22023 AMROS): a randomized, multicenter, open-label, phase 3 non-inferiority trial. Lancet Oncol 2014; 15:1303-1310 Kumar.P, Clark.M, Ninth edition Kumar & Clark's Clinical Medicine, Johnson.J.M, Eva.E.G, Booth.S, Palliative medicine and symptom control, 2017: 31-42

2.6.ETIOLOGJIA



Trakti gastrointestinal (GI) është pjesë e sistemit të tretjes, i cili përpunon lëndë ushqyese (vitamina, minerale, karbohidrate, yndyrna, proteina dhe ujë) në ushqimet që hahen dhe ndihmon që të kalojë materialin e mbeturinave jashtë trupit. Trakti GI përfshin stomakun dhe zorrët . Stomaku është një organ në formë J në pjesën e sipërme të barkut. Ushqimi lëviz nga fyti në stomak përmes një tubi, muskuloz të

Fig.9.Trakti Gastrointestinal i poshtëm¹⁷ quajtur ezofag. Pas largimit nga stomaku, ushqimi i tretur pjesërisht kalon në zorrën e hollë dhe pastaj në zorrë të trashë.

Sistemi GI nuk është një sistem pasiv , ai ka një rol ndijor dhe reagon ndaj materialeve që rrjedhin përmes tijë.

Sistemi GI funksionon në menyrë të rregullt përderisa nuk shfaqet ndonjë faktor predispozues që ti shkaktoj shqetësime të ndryshme.

Shkaqet kryesore të problemeve gastrointestinale janë alergjitë e ushqimeve, semundjet kronike, shqetsimet e tjera GI vijnë si pasoj e semundjeve kronike, medikamenteve, teknikave diagnostike dhe terapeutike.

Shkaktaret mund të jenë të ndryshem varsisht nga semundja e pacientit, shqetësimet që shfaqen më se shpeshti janë: Konstipacioni, impakti fekal, zvogelimi i zorrës, diarea, enteriti rrezatues, vjedheja dhe nausea. ¹⁸

Komplikimet e GI janë të zakonshme në pacientët me kancer, komplikimet janë probleme mjekësore që ndodhin gjatë një sëmundjeje, ose pas një procedure ose trajtimi. Ato mund të shkaktohen nga sëmundja, procedura ose trajtimi, ose mund të kenë shkaqe të tjera. ¹⁹


¹⁷<https://www.google.com/search?biw=1517&bih=735&tbm=isch&sa=1&ei=gXkEWqjWKOPMgAaw57GYBg&q=gastrointestinal+tract&oq>

¹⁸ Fauci, Braunwald, Kasper, Hauser, Longo, Jamson, Loscalzo, Parimet e Mjekësisë Interne

¹⁹ https://www.cancer.gov/about-cancer/treatment/side-effects/constipation/GI-complications-pdq#section/_1

2.7.Konstipacioni (Kapslleku)

Kapsllëku paraqet lodhje të ulët ose ngadalësim të procesit peristaltik, duke rezultuar në heqjen e vështirë të përmbajtjes së pa nevojshme jashtëqitjes (fekalieve ose fecesi)



Fecesi mund të grumbullohet në zorrën e trashë dhe rezulton më reagime toksike dhe të dhimbshme, kontraktimet e kolonit janë të shoqëruara më spazma të dhimbshme si pasojë e bllokimit të levizjeve të fekalieve. Shkaqet më të shpeshta të kapsllëkut janë

Fig.10.Grumbulli i fecesit në zorrën e trash. ndryshime në dietë, pa pirë lëngje të mjaftueshme, dhe duke qenë më pak aktive janë shkaqe të zakonshme të kapsllëkut.

Shkaqe të tjera të kapsllëkut përfshijnë: medikamentet opioide dhe medikamentet e tjera të dhimbjes, kjo është një nga shkaqet kryesore të kapsllëkut tek pacientët me kancerit, kimioterapia, barna për ankth dhe depresion, diuretikë, shtesa si hekuri dhe kalciumi, droga të përdorura për anestezi (për të shkaktuar humbjen e ndjenjave për kirurgji ose procedura të tjera kirurgjike, nuk shkojnë në banjë kur ndihet nevoja për një lëvizje të zorrëve, përdorimi i laksativave nga një here dhe shumë shpesh.

Testet dhe procedurat e mëposhtme bëhen për të ndihmuar në gjetjen e shkakut të kapsllëkut: kontrolli i trupit palpacion, perkusion dhe auskultacion.

Mjeku do të kontrollojë për tingujt e zorrëve dhe dhimbjet në bark, kontrolli dixhital i zorrës së trashë, një kontroll i rektumit, mjeku apo infermierja fut një gisht të lubrifikuar me gloves në pjesën e poshtme të rektumit për t'u ndjerë për prezencen ndonje gunge apo ndonjë gjë tjetër që duket e pazakontë. Në femra, vagina gjithashtu mund të shqyrtohet.

Test i gjakut okular i fekaleve: një test për të kontrolluar jashtëqitjen se mos është prezent gjaku që mund të shihet vetëm me një mikroskop.

Testet imazherike proktoskopia, kolonoskopia dhe një X-ray i abdomenit.²⁰

²⁰ https://www.cancer.gov/about-cancer/treatment/side-effects/constipation/GI-complications-pdq#section/_8

2.8. Opstipacioni

Opstipacioni është një masë e materieve të panevojshme të thatë dhe të forta që nuk do të kalojë nga zorra e trashë ose rektumit.

Simptomat e zbërthimit fekal përfshijnë mungesën e lëvizjes së zorrëve dhe dhimbjen në bark ose mbrapa.

Vlerësimi përfshin një kontroll fizik dhe pyetje si ato të bëra në vlerësimin e kapsllëkut se qfarë dhimbjeve ndjen, a ka gazra etj, opstipacioni zakonisht trajtohet me një klizmë.

Simptoma tek pacientët me opstipacion mund të mos jenë gastrointestinale (GI), në vend të kësaj, ata mund të kenë probleme me qarkullimin, zemrën ose frymëmarrjen.

Shkaktaret me të shpeshtë janë: Medikamentet e dhimbjes, opioid, përdorimi i laksativeve shpesh.

Simptomat: Simptomat përfshijnë mungesën e lëvizjes së zorrëve dhe dhimbjen në bark ose mbrapa, në vijim mund të jenë simptomat e opstipacionit:

- Nuk mund të ketë lëvizje të zorrëve.
- Duhet të shtyjnë më shumë për të pasur një lëvizje zorrë të sasive të vogla të feqeve të forta dhe të thata.
 - Dhimbje në shpinë ose në bark.
 - Urinon më shumë se zakonisht, ose nuk mund të urinojë.
 - Problemet e frymëmarrjes, rrahjet e shpejta të zemrës, marramendja, presioni i ulët i gjakut dhe barku i fryrë.
 - Të keni diarre të papritur dhe eksplozive
 - Përzierje dhe vjellje.
 - Dehidratim.
 - Të hutoheni dhe të humbni ndjenjën e kohës dhe vendit, me rrahje të shpejtë të zemrës, djersitje, temperaturë dhe presion të lartë ose të ulët të gjakut. Këto simptoma duhet të raportohen te ofruesi i kujdesit shëndetësor.

Testet e gjakut, EKG, kontrolli i trupit.²¹

²¹ https://www.cancer.gov/about-cancer/treatment/side-effects/constipation/GI-complications-pdq#section/_15

Fauci, Braunwald, Kasper, Hauser, Longo, Jamson, Loscalzo, Parimet e Mjekësisë Interne

2.9.Zvogëlimi i lumenit të zorres

Blokimet e zorrëve mund të shkaktohen nga një ndryshim fizik ose nga kushtet që ndalojnë lëvizjen e muskujve të zorrëve normalisht. Zorrët mund të bllokohen pjesërisht ose tërësisht.

Kanceret më të zakonshme që shkaktojnë pengesa të zorrëve janë kanceret e zorrës së trashë, stomaku dhe vezoret.

Trajtimi është i ndryshëm për pengesat akute dhe kronike të zorrëve.

Ndryshimet fizike.Zorrët mund të bëhen të përdredhura ose të formojnë një lak, duke e mbyllur atë dhe duke zënë kokën, inflamacioni i indeve nga operacioni dhe herniet mund ta bëjnë zorrën shumë të ngushtë.

Nëse zorrët bllokohen nga shkaqe fizike, mund të zvogëlohet rrjedhja e gjakut në pjesën e bllokuara.

Kushtet që ndikojnë në muskujt e zorrëve:

- Paralizë (humbja e aftësisë për të lëvizur).
- Enët e gjakut të bllokuara që shkojnë në zorrë.
- Kalium shumë i vogël në gjak.

Kanceret e tjera, të tilla si kanceret e mushkërive dhe të gjirit dhe melanoma, mund të përhapen në bark dhe të shkaktojnë pengim të zorrëve. Pacientët që kanë operuar në abdomen ose terapia me rrezatim në barkë kanë një rrezik më të lartë për pengimin e zorrëve. Blokimet e zorrëve janë më të zakonshme gjatë fazave të avancuara të kancerit.

Vlerësimi dhe testet përfshijnë kontrollin fizik dhe analiza të imazherike.²²

²² https://www.cancer.gov/about-cancer/treatment/side-effects/constipation/GI-complications-pdq#section/_15

Fauci, Braunwald, Kasper, Hauser, Longo, Jamson, Loscalzo, Parimet e Mjekësisë Interne

2.10.Diarrea




Fig.11.Diarea²⁴

Shkaqet e diarresë të pacientët më kancer përfshijnë trajtimet të tilla si kimioterapia, terapia me rrezatim, transplantimi i palcës së eshtrave dhe kirurgjia.

Më shumë se gjysma e pacientëve që marrin kimioterapinë kanë diarre që duhet të trajtohen.

Terapia e rrezatimit në abdomen dhe legen mund të shkaktojë inflamacion të zorrëve, pacientët mund të kenë probleme në tretjen e ushqimit, kanë gazra, dhimbje dhe diarre. Këto simptoma mund të zgjasin deri në 8-12 javë pas trajtimit ose mund të mos ndodhin.

Pacientët të cilët kanë një transplant të palcës së eshtrave të donatorëve mund të zhvillojnë sëmundje transfuzive-pritëse (GVHD). Simptomat e stomakut dhe të zorrëve të GVHD përfshijnë mundime dhe të vjella, dhimbje të rënda të barkut si dhe diarre të holluar në formë uji, të gjelbër, simptomat mund të shfaqen 1 javë deri në 3 muaj pas transplantimit.

Vlersimet dhe testimet e Diarres: Kontrollimi fizik dhe historia shëndetësore e pacientit. Kontrollimi do të përfshijë kontrollin e presionit të gjakut, pulsit dhe frymëmarrjen; kontrollin për tharjen e lëkurës dhe indeve që mbulojnë brenda gojës; dhe duke kontrolluar për dhimbjen e barkut dhe tingujt e zorrëve.

Kontrolli dixhital i zorrës së trashë, një kontroll i rektumit.

Testimet e fecesit : Testet laboratorike për të kontrolluar nivelin e ujit dhe natriumit në jashtëqitje, dhe për të gjetur substanca që mund të shkaktojnë diarre. Fecesi kontrollohet gjithashtu edhe për infeksione bakteriale, kërpudhore ose virale.

Analizat komplet të gjakut, elektrolitet, analiza e urines, X-ray.

²³ Fauci, Braunwald, Kasper, Hauser, Longo, Jamson, Loscalzo, Parimet e Mjekësisë Interne.

²⁴ <https://www.google.com/search?q=diarrhea&tbm=isch&tbs=rimg>

2.11. Enteriti rrezatues

Enteriti rrezatues është inflamacion i zorrëve i shkaktuar nga terapia e rrezatimit, simptomat mund të fillojnë gjatë terapisë së rrezatimit ose muaj pas.

Enteriti i rrezatues mund të jetë akut ose kronik.

Enteriti akut rrezatues ndodh gjatë terapisë rrezatuese dhe mund të zgjasë 8-12 javë pas ndalimit të trajtimit.²⁵

Enteriti kronik i rrezatimit mund të shfaqet disa muaj pas ose pas disa vitesh pas përfundimit të terapisë rrezatuese.

Vetëm 5% deri në 15% e pacientëve të trajtuar me rrezatim në barkë do të kenë probleme kronike.

Shuma e kohës që zgjat enteriti dhe sa e rëndë varet nga sa vijon:

- Doza e përgjithshme e rrezatimit të marrë.
- Sasia e zorrëve normale të trajtuar.
- Madhësia e tumorit dhe sa është përhapur
- Nëse kemioterapia është dhënë në të njëjtën kohë si terapia e rrezatimit.
- Nëse përdoren implantet e rrezatimit.
- Nëse pacienti ka presion të lartë të gjakut, diabet, sëmundje inflamatore të pelvikut, ose ushqim të dobët.

²⁵ https://www.cancer.gov/about-cancer/treatment/side-effects/constipation/GI-complications-pdq#section/_8

Tab.2 Enteriti akut dhe kronik kanë simptoma që janë shumë të ngjashme.^{26 27}

Pacientët me enteritis akut	Pacientët me enteritis kronik
Përzier, të vjella	Dhimbje barku
Dhimbje barku	Diarre e përgjakshme
Shpesh kërkon të ketë lëvizje të zorrëv	Shpesh kërkon të ketë lëvizje të zorrëve
Dhimbje rektale, gjakderdhje ose mukus në jashtëqitjes	Jashtëqitje yndyrore
Diarre të ngurtë	Humbje peshe
Ndjenja shumë e lodhur	Përzier.

Simptomat e enteritit akut zakonisht kalojnë 2 deri në 3 javë pas përfundimit të trajtimit. Simptomat e enteritit kronik zakonisht shfaqen 6 deri në 18 muaj pas përfundimit të terapisë rrezatuese. Mjeku gjithashtu do të duhet të njohë historinë e plotë të pacientit për trajtimet me rrezatim.

Vlerësimi i enterit të rrezatimit përfshinë një kontroll fizik dhe pyetje për pacientin. Pacientëve do t'u behët një kontroll fizik dhe do të bëhen pyetje për sa vijon: modeli i zakonshëm i lëvizjeve të zorrëve, modeli i diarresë: kur ajo filloi, sa kohë zgjat, sa shpesh ndodh, shuma dhe lloji i jashtëqitjes, simptoma të tjera me diarre (të tilla si gazi, ngërçi, gjakderdhje dhe dhimbje rektale).

²⁶ https://www.cancer.gov/about-cancer/treatment/side-effects/constipation/GI-complications-pdq#section/_36

²⁷ Kumar.P, Clark.M, Ninth edition Kumar & Clark s Clinical Medicine, Box.17.3 Some causative factors associated with the development of cancer2017: 604

2.12. Vjellja

Shumë kushte gastrointestinale (dhe jo-gastrointestinë) lidhen me të vjella. Vjellja rregullohet nga qendrat komplekse të kontrollit të refleksit, të vendosura në formimin retikular lateral të medullës, të cilat stimulohen nga zonat e shkaktuara kimiorceptor (CTZ) në dyshemënë e barkut të katërt dhe gjithashtu nga aferentët vagalë nga zorrë. Zonat qendrore stimulohen drejtpërdrejt nga toksinat, drogat, sëmundjet e lëvizjes dhe distrubancat metabolike. Presioni intracranial i ngritur ka një efekt të drejtpërdrejtë në qendrën e vjelljes, që çon në të vjella. Toksinat lumore, inflamacionet dhe pengesat mekanike janë shkaqet gastrointestinale lokale të të vjellave.

2.13. Mundim në vjellje (Nauze)

Nauzea është një ndjenjë e dëshirës për të vjellë, shpesh të shoqëruar me efekte autonome, duke përfshirë zverdhje, zbehje dhe djersitje, shpesh paraprin vjelljen aktuale. Përpyekje të pavullnetshme, joproduktive për të vjellë, të shoqëruara me tkurrjen e muskujve të barkut, por pa dëbuar përmbajtjen e stomakut përmes gojës. Këto simptoma zhvillohen sepse rrezatimi mund të nxisë ndryshimin në një ose më shumë funksione të veçanta fiziologjike në pjesët e ndara gjerësisht të traktit gastrointestinal që shtrihen në rrugën e rrezeve të radioterapisë. Për më tepër, sëmundja subklinike para-ekzistuese mund të destabilizohet për shkak të ndryshimeve të vogla gastrointestinale të shkaktuara nga radioterapia.²⁸

²⁸ Kumar.P, Clark.M, Ninth edition Kumar & Clareck s Clinical Medicine, Clinical approach to the patient with gastrointenstinal disease , 2017: 359-360.

2.14.Kujdesi ndaj pacienteve onkologjik

Kujdesi që i ofrohet pacienteve onkologjik është kujdesi paliativ. *Kujdesi paliativ është kujdesi total aktiv i pacientëve të cilët kanë sëmundje të avancuar, progresive, të shkurtimit të jetës.* Ajo duhet të bazohet në nevojat dhe jo diagnozën, dhe kërkohet në sëmundjet jo-malinje, si dhe në kancer. Qëllimi i kujdesit paliativ është të arrihet cilësia më e mirë e mundshme e jetës për pacientët dhe kujdestarët e tyre duke bër:

- menaxhimin e problemeve fizike, psikologjike, sociale dhe shpirtërore në mënyrë që të sigurohet një kontroll i shkëlqyeshëm i simptomave
- duke u mundësuar pacientëve që të kujdesen dhe të vdesin në vendin e zgjedhjes së tyre
- duke bërë të mundur pranimin e vdekjes si një proces normal kur trajtimet zgjatose të jetës nuk përmirësojnë ose ruajnë cilësinë e jetës
- duke siguruar mundësinë për të thënë lamtumirë dhe për të sjellë mbylljen.

Kujdesi i mirë paliativ integron kontrollin e simptomave me qasje të përshtatshme jo-farmakologjike, të tilla si menaxhimi dhe rehabilitimi i ankthit.

